



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
KOMISIONI INSTITUCIONAL ZGJEDHOR

Prot. 34 / 1 Nr.

Durrës, më 13 / 2 / 2023

VENDIM
NR 8, datë 13 / 2 / 2023

“Për shtyrjen e afatit të aplikimeve për anëtar i Bordit të Administrimit përfaqësues i studentëve”

Në mbështetje të ligjit, Nr. 80/2015, datë 17/09/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", VKM nr.782, datë 26.12.2018 'Për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurave të përzgjedhjes së anëtarëve të Bordit të Administrimit, përfaqësues të MAS, në institucionet publike të arsimit të lartë", Shkresës së MAS Nr.7739/1 prot., datë 22.12.2022 "Kthim përgjigje", të Rregullores "Për organizimin e zgjedhjeve për Autoritetet dhe Organet Drejtuese në Universitetin "Aleksandër Moisiu" Durrës", e miratuar me vendim Senati Akademik nr.43, datë 11.02.2020, urdhërit nr.19, datë 15.07.2022 të Rektorit "Për rishpalljen e zgjedhjeve për anëtar të Bordit të Administrimit përfaqësues i studentëve në Universitetin "Aleksandër Moisiu, Durrës", Komisioni Institucional i Zgjedhjeve,

VENDOSI:

1. Shtyrjen e afatit të aplikimeve për anëtar i Bordit të Administrimit përfaqësues i studentëve;
2. Dorëzimi i dokumentacionit të kandidatëve për anëtar të Bordit të Administrimit përfaqësues i studentëve, do të zhvillohet nga data **13.02.2023** deri në datën **17.02.2023** me postë zyrtare në protokoll arkivën e UAMD me emërtesë "Aplikim për anëtar i Bordit të Administrimit";
3. Bashkëlidhur vendimit kriteret dhe dokumentacioni i cili do të dorëzohet për aplikim;
4. Data e zhvillimit të zgjedhjeve do të jetë data **31.03.2023**;
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Klodiana LEKA

